

UDHËZIM
Nr. 20, datë 2.12.2022

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN E MINISTRIT NR. 2, DATË 15.3.2022,
“PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE SPECIFIKE PËR AMBALAZHIMIN DHE
ETIKETIMIN E PMB-ve”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, si dhe të nenit 24, pika 4, të ligjit nr. 105/2016, datë 14.10.2016, “Për mbrojtjen e bimëve”,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin e ministrit nr. 2, datë 15.3.2022, bëhen ndryshimet, si më poshtë:

1. Shkronjat “a” dhe “c” të pikës 3 shfuqizohen.
2. Te shkronja “e” e pikës 6, shprehja “si dhe autorizim” bëhet “dhe/ose autorizim”.

Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit si dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca